



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. 257 Prot.  
11

Tiranë, më 20.01, 2021

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**  
(Mbledhje me dyer të mbyllura)

(Mbajtur, më 13.11.2020).

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore për emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Lartë të kandidatit z. “ ” (relator z. Ilir Toska).

**Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.**

**Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:20 dhe mbaroi në orën 12:50.**

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. **Naureda Llagami** (kryetare)
2. **Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
3. **Medi Bici** (anëtar)
4. **Brunilda Kadi** (anëtare)
5. **Dritan Hallunaj** (anëtar)
6. **Ilir Toska** (anëtar)
7. **Brikena Ukperaj** (anëtar)
8. **Marçela Shehu** (anëtare)
9. **Erjon Muharremaj** (anëtar)

**Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor**  
**Tiranë, më 13.11.2020 (Pika 1)**

**Shënim:** Nuk morën pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtarë i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. *Alban Toro* si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. *Fatmira Luli*.

### RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Lartë të kandidatit z. \_\_\_\_\_ (shtyrë nga mbledhja e datës 19.10.2020).

Relatori i kësaj çështjeje është z. Ilir Toska, i cili parashtron shkurtimisht opinionin e tij lidhur me projektvendimin “Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për emërimin si gjyqtar në Gjykatën e Lartë të kandidatit z. \_\_\_\_\_”.

Në cilësinë e relatorit po parashtrojë opinionin tim rreth përmbushjes së kushteve dhe kriterëve të kandidimit për në Gjykatën e Lartë, nga ana e kandidatit z. \_\_\_\_\_.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 136, pika 3, përcakton:

*3. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Kandidatët që përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë gradë shkencore në drejtësi.*

Kushti i kandidimit për pasjen jo më pak se 15 vjet përvojë si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës, si dhe mbajtja gradë shkencore në drejtësi, përcaktohet edhe në pikën 1, të nenit 49, të Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ndërkohë, në këtë dispozitë të ligjit, përcaktohen edhe kritere të tjera për kandidimin në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur. Pra, si kusht parësor për kandidimin në Gjykatën e Lartë për juristët e spikatur, përcaktohet përvoja profesionale, në masën dhe llojin e saj.

---

**Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor**  
**Tiranë, më 13.11.2020 (Pika 1)**

2

Kushtetuta dhe ligji nuk kanë ndonjë definicion për kategorinë “jurist i spikatur” në kuptim të dispozitave si më lart, por është krejt e qartë se i tillë mund të jetë vetëm juristi që ka jo më pak se 15 vjet përvojë, në profesionet avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës.

Në rastin konkret, kandidati, z. [ ] , deri në momentin e kandidimit, pra deri më datë 26.09.2019, ka gjithsej 15 vjet e 9 muaj përvojë profesionale, duke konsideruar që ai ka fituar titullin “jurist” në dhjetor 2003, pra në kohën kur ai referon të ketë shlyer provimet dhe është diplomuar (domethënë jo kohën kur është lëshuar diploma përkatëse, më datë 03.02.2004). Në këtë periudhë përfshihet edhe periudha e punës së kandidatit në zyrën e Avokatit [ ] .


[ ] , Greqi, pra deri në Nëntor 2005, domethënë një periudhë 24 mujore.

Nga verifikimi i kryer ka rezultuar se në zyrën e Avokatit [ ] Greqi, kandidati ka qenë i punësuar si “jurist”, duke ofruar shërbimet e tij sipas urdhrave dhe kërkesave të punëdhënësit të tij avokat, domethënë ka përgatitur akte në fushën e avokatisë sipas shërbimit që avokati punëdhënës i kandidatit ofronte.

Gjithsesi, pavarësisht llojit të shërbimeve të kandidatit, që praktikisht, nga sa avokati punëdhënës i tij referon, ato kanë qenë shërbime të një asistent avokati, juridikisht ato nuk kanë qenë të tilla për sa kohë që kandidati nuk ka patur këtë status, sikurse një gjë e tillë është pranuar edhe nga ai në shpjegimet e parashtuara, më datë 04.11.2020, në lidhje me gjetjet e procedurës së verifikimit. Pra, për këtë periudhë 24 mujore, kandidati ka ofruar shërbime si jurist në fushën e avokatisë, por jo si asistent avokat dhe, aq më pak, si avokat. Ndërkohë, Kushtetuta dhe ligji, sa i përket fushës së avokatisë, kërkojnë pasjen e përvojës së avokatit.

Në këto kushte, përvoja e kandidatit për periudhën dhjetor 2003 - nëntor 2005, nuk mund të konsiderohet si përvojë profesionale si avokat dhe, aq më pak, ndonjë prej përvojave të tjera të kërkuara shprehimisht nga Kushtetuta dhe ligji.

Për rrjedhojë, në vlerësimin tim, kandidati, në momentin e kandidimit, nuk ka përmbushur kushtin e pasjes së përvojës profesionale minimale prej jo më pak se 15 vjet. Në fakt, në momentin e kandidimit, kandidati ka patur vetëm 13 vjet e 9 muaj përvojë profesionale nga ato që kërkon Kushtetuta dhe ligji, pra 15 muaj më pak nga përvoja profesionale minimale e kërkuar.




Lidhur me analogjinë që kandidati përpiqet t'i bëjë situatës së tij me atë të një kandidati tjetër në një proces tjetër ligjor dhe përpara një organi tjetër kushtetues, si dhe kërkesa e tij për të konsideruar ky Këshill vlerësimin e bërë nga ai organ në atë rast, pa dashur të futem në krahasueshmërinë e rasteve, në vlerësimin tim kërkesa e kandidatit parimisht është e papranueshme. Për këtë sjell në vëmendjen tuaj qëndrimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor në Vendimin nr. 162, datë 11.09.2019, ku ndër të tjera ka arsyetuar se: "... çdo organ i administratës publike ka detyrimin që, gjatë veprimtarisë së tij, të respektojë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjet dhe aktet e tjera normative në fuqi. Vendimi i një organi publik nuk është i detyrueshëm për organet e tjera publike, përveç kur parashikohet ndryshe në ligj. Në rastin konkret, kandidati nuk evidenton ndonjë qëndrim të ndryshëm të mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor gjatë veprimtarisë së tij, në kuadër të zbatimit nga ai të funksionit të tij kushtetues të përcaktuar në nenin 147/a, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, atë të propozimit Presidentit të Republikës të kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, funksion për ushtrimin e të cilit Këshilli ka detyrimin kushtetues dhe ligjor të respektojë legjisllacionin përkatës të miratuar për këtë qëllim, pikërisht Kushtetutën (nenin 136) dhe Ligjin 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Mbi sa parashtrova, në vlerësimin tim, kandidati z. nuk përmbush një nga kushtet e kandidimit, atë të përvojës profesionale minimale, shkak për të cilin mendoj se Këshilli i Lartë Gjyqësor është para rastit për të vendosur skualifikimin e kandidatit dhe përjashtimin e tij nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e tij nr.172, datë 11.09.2019. Nisur nga kjo, sa kohë kandidati nuk përmbush një nga kushtet e kandidimit, mendoj se është e panevojshme vënia në diskutim e rezultateve të verifikimit sa i përket përmbushjes nga kandidati të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit.

Fjalën e merr **zonja Shehu** e cila pyet zotin Toska nëse Këshilli duhet të shprehet vetëm për këtë kriter.

**Zoti Toska** përgjigjet se ky kriter sjell skualifikimin e kandidatit, pasi nëse ai nuk përmbushë njërin prej kriterëve ligjore, s'ka nevojë të kalohet te kriteret e tjera. Ndaj zoti Toska



propozon që Këshilli të vendosë skualifikimin dhe përjashtimin e kandidatit jogjyqtar z. . . . .  
nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës  
civile, të shpallur me Vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Hidhet në votim propozimi i relatorit, zotit Toska dhe votimi vijon si më poshtë:

**Maksim Qoku:** Kundër!

**Brunilda Kadi:** Kundër!


**Dritan Hallunaj:** Kundër!

**Illir Toska:** Dakord!

**Marçela Shehu:** Edhe zonja Shehu është dakord, duke konsideruar qëndrimin përfundimtar të zotit i cili periudhën e diskutuar nga Këshilli nuk e lidhë më me të qenit asistent avokat, por me të qenit jurist, në vlerësimin e saj, kjo eksperiencë pune nuk përfshihet në atë që kërkon ligji. Ajo vlerëson se puna si jurist pranë një avokati nuk përbën jurist të nivelit të lartë siç kërkon ligji.

**Erjon Muharremaj:** Pro. Për shkak të natyrës së veçantë të detyrës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, kushtetutëbërësi ka renditur në mënyrë specifike pozicionet e ndryshme të punës që konsiderohen si të vlefshme për kandidatët konkurrues. Nuk është i rastësishëm dallimi në Kushtetutë midis nenit 136, që përcakton kriteret e anëtarit jogjyqtar të Gjykatës së Lartë, me nenin 147, që përcakton kriteret e anëtarit jogjyqtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku ky i fundit përzgjidhet nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, pa përmendur ndonjë pozicion specifik. Nëse kushtetutëbërësi do të kishte synuar pranimin e çfarëdolloj përvoje për kandidatët për anëtar të Gjykatës së Lartë, nuk do të bënte dallim me përvojën për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, e nuk do të rendiste në mënyrë specifike përvojat si avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës.

**Brikena Ukperaj:** Kundër! Zonja Ukperaj shprehet, se periudha 12.12.2003 deri në nëntor 2005 nuk përbën përvojën minimale si avokat, por përbën jurist i nivelit të lartë në fusha të tjera të së drejtës. Nuk ka në legjislacion një listë shteruese për këtë nocion, ndaj bëhet një interpretim i tij rast pas rasti. Në bazë të nenit 49 të ligjit nr. 96/2016 përvoja e zotit pranë



Zyrës së Avokatisë në Greqi, nuk mund të konsiderohet si eksperiencë si Avokat apo Asistent Avokat, por ajo konsiderohet si jurist i nivelit të lartë në fusha të tjera të së drejtës. Duke parë të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga z. , si dhe veçanërisht vërtetimin e lëshuar nga Avokati , me gjithë përshkrimin e punës së tij pranë kësaj zyre, është i mjaftueshëm që ai të konsiderohet jurist i nivelit të lartë në fusha të tjera të së drejtës. Në të thuhet se z. ka shërbyer si oficer ligjor, apo jurist, ka ndihmuar në trajtime gjyqësore dhe jogjyqësore, ka bërë kërkime në legjislacionet e vendeve të tjera, ka përgatitur fashikuj gjyqësor për përfaqësime gjyqësore, draftuar kontrata civile e tregtare, etj. Pra, vlerësimet janë maksimale për këtë periudhë punë që ai ka ushtruar pranë Zyrës së Avokatisë në Greqi. Për sa më sipër, zonja Ukperaj është kundër skualifikimit të zotit nga procedura për emërimin në Gjykatën e Lartë.

**Medi Bici:** Kundër, pasi z. plotëson të gjitha kërkesat e ligjit.

**Naureda Llagami:** Dakord, pasi ai nuk plotëson kriterin e vjetërsisë.

Këshilli e rrëzoi propozimin e zotit Toska për skualifikimi/përfjashtimin e kandidatit jogjyqtar z. nga procedura e emërimit në Gjykatën e Lartë.

Në këto kushte, zonja Llagami, bën një propozim të ri, dhe i propozon Këshillit kualifikimin e kandidatit jogjyqtar z. në vijimin e procedurë së emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Maksim Qoku:** Pro!

**Brunilda Kadi:** Pro!

**Dritan Hallunaj:** Pro!

**Ilir Toska:** Kundër!

**Marçela Shehu:** Kundër!

**Erjon Muharremaj:** Kundër!

**Brikena Lubonja:** Pro!

**Medi Bici:** Pro!

**Naureda Llagami:** Kundër!

Në përfundim, Këshilli vendosi kualifikimin e kandidatit jogjyqtar dhe vijimin e procedurës të emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr.172, datë 11.09.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Një kopje e arsyetuar e vendimit t'i njoftohet kandidatit z. sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



**Kryetare  
NAUREDA LLAGAMI**

**Zëvendëskryetar  
MAKSIM QOKU**

**Anëtar  
MEDI BICI**

**Anëtar  
ILIR TOSKA**

**Anëtare  
BRIKENA UKPERAJ**

**Anëtare  
BRUNILDA KADI**

**Anëtare  
MARÇILA SHEHU**

**Anëtar  
ERJON MUHARREMAJ**

**Anëtar  
DRITAN HALLUNAJ**

Mbajtur, Specialiste  
Ermira Kodra (Lleshi)

**Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor  
Tiranë, më 13.11.2020 (Pika 1)**